

VENDIM
Nr. 1, datë 11.1.2006

**PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA “KORSEL” SHPK TE
SHOQËRIA “MAKSI ELEKTRIK” SHPK**

(Ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 16.2.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pikës 1.4 “Kushtet e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike ekzistuese me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k., për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në Hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. *me një afat 28-vjeçar*.

2. Miratimin e transferimit të aseteve të shoqërisë “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. me të njëjtën vlerë aset.

3. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.12, datë 7.04.2004, “Për licencimin e shoqërisë “Korsel” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike për hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të rrethit të Korçës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema